

Të dhëna bazike të lëndës - SYLLABUSI				
Njësia akademike:	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike			
Departamenti	Termoenergjetika dhe Energjia e Ripërtërishme			
Titulli i lëndës:	Komforti termik			
Niveli:	Master			
Statusi lëndës:	Obligative/Zgjedhore			
Semestri	I (7)			
Numri i orëve në javë:	2+2			
Vlera në kredi – ECTS:	6			
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Rexhep Selimaj			
Përshkrimi i lëndës	<p>Qëllimi i këtij kursi është që të sigurojë një kuptim të plotë të asaj se si ventilimi dhe ngrohja / ftohja ndikojnë në komfortin termik, dhe cilësinë e ajrit të brendshëm, dhe se si kjo, nga ana tjetër reflekton për menaxhimin e energjisë në mjedisin e ndërtesës. Komforti termik dhe hapësira e kondicionuar analizohen në sfondin e kërkesave fiziologjike të njeriut. Metodatat e ndryshme për vlerësimin e komfortit termik paraqiten për mjedise të ndryshme të brendshme (industri, zyra, banesa, etj.). Poashtu analizohen aspektet arkitektonike, sjellja e njeriut në punë në mundësitë për rritjen e efikasitetit të energjisë dhe faktorët që ndikojnë në cilësinë e ajrit, efektet shëndetësore, rregulloret / standardet ekzistuese dhe masat e kontrollit të parametrevave të klimatizimit të ajrit.</p>			
Qëllimet e lëndës:	Aftësimi i studentëve në konceptimin, analizimin dhe në krijimin e kushteve të komfortit termik.			
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të kursit studenti duhet të jetë i vetëdijshëm për efektet e ngrohjes dhe ventilimit në cilësinë e ajrit të brendshëm dhe të komfortit termik, si dhe implikimet për menaxhimin e energjisë në mjedisin e ndërtuar. Për më tepër studentët duhet të jenë të njohur me konceptin e vlerësimit mjedisor të ndërtimit dhe skemat e ndryshme të vlerësimit dhe mjete komerciale në dispozicion.			
Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënies të studentit)				
Aktiviteti	Orë	Ditë	Javë	Gjithsej
Ligjërata	2		15	30
Ushtrime teorike / laboratorike	2		15	30
Punë praktike	2		2	4
Kontaktet me mësimdhënësin / konsultimet	0.25		12	3
Ushtrime në teren	4		2	8
Kolokiume, seminare	2		2	4
Detyra të shtëpisë	3	4		15
Koha e studimit vetanë të studentit (bibliotekë ose shtëpi)	2	13		26
Përgatitja përfundimtare për provim	4	4		16
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2		4	8
Projektet, Prezantimet, etj.	1		7	7
Totali				151
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata me anë të prezantimeve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, teste, diskutime			
Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik: (Detyrat e shtëpisë, Kolokiume, Seminare, Projekte, etj.)	Pjesa teorike		Pjesa praktike	
	40%		60%	

Mënyra e dhënies së provimit:	Testimi gjatë vitit, seminarët dhe provimi përfundimtar.		
Literatura bazë:	[1] Fejzullah Krasniqi, Rexhep Selimaj: <i>Komforti termik</i> , ASHAK, Prishtinë, 2020. [2] K.C.Parsons: <i>Human Thermal Environments</i> , CRC Press, 2014. [3] Y. Tochihara, T. Ohnaka: <i>The Ergonomics of Human Comfort, Health and Performance in the Thermal Environment</i> , Academic Press, Elsevier, 2005.		
Literatura shtesë:	[1] D. E. Kalz, J. Pfafferoth: <i>Thermal Comfort and Energy-Efficient Cooling of Nonresidential Buildings</i> , Springer International Publishing, 2014. [2] ASHRAE: <i>Standard for the Design of High-Performance Green Buildings Except Low-Rise Residential Buildings</i> (ANSI ASHRAE 189.1-2009), Kessinger Publishing, LLC, 2009. [3] Kristian Fabbri: <i>Indoor Thermal Comfort Perception</i> , © Springer International Publishing Switzerland 2015. [4] P.O. Fanger: <i>Thermal Comfort</i> , 1970.		
Plani i dizajnuar i mësimit:			
Java	Ligjërata që do të zhvillohet		
<i>Java e parë:</i>	Prezantimi i Syllabusit për lëndën. Hyrje, historia, konceptet dhe definicionet për komfortin termik.		
<i>Java e dytë:</i>	Ajri i lagësht dhe parametrat e gjendjes.		
<i>Java e tretë:</i>	Klima dhe masat mbrojtëse në ndërtesa.		
<i>Java e katërt:</i>	Këmbimi i nxehtësisë ndërmjet njeriut dhe mjedisit.		
<i>Java e pestë:</i>	Adaptimet, Faktorët fiziologjikë, psikologjikë dhe fizikë (sjellja), nxehtësia dhe temperatura, kontrolli i temperaturës së njeriut.		
<i>Java e gjashtë:</i>	Specifikat dhe ndjeshmëria, diferencat individuale, diferencat biologjike gjinore, diferencat regjionale, mjediset mjekësore. Nxehtësia nga lëkura dhe respiracioni.		
<i>Java e shtatë:</i>	Faktorët influencues të njeriut, sasia metabolike, veshja, temperatura e ajrit, temperatura mesatare e rrezatimit, shpejtësia e ajrit, lagështia relative, ventilimi natyral. Sistemi i termorregullimit të njeriut.		
<i>Java e tetë:</i>	Vlerësimi i parë intermediar.		
<i>Java e nëntë:</i>	Modelimi dhe sistemi termik i njeriut. Modelet e balancit termik të njeriut.		
<i>Java e dhjetë:</i>	Parashikimi i votës mesatare dhe parashikimi i përqindjes së pakënaqësisë.		
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Modelet e diskomforti lokal termik.		
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Modelet adaptive të komfortit.		
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Standardet e komfortit termik. Analiza e komfortit termik të njeriut në kushte të Kosovës.		
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Vlerësimi dhe diskutimi lidhur me rezultatet e arritura të mësimit gjatë semestrit dhe përgatitja për provimin final		
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Vlerësimi i dytë intermediar.		
Vlerësimi përfundimtar i studentëve:			
Mënyra e dhënies së provimit:	Vlerësimi përfundimtar i studentëve:	Nota përfundimtare:	
	- Pjesëmarrja dhe aktiviteti	Pikët (%):	10 (dhjetë) (A)
	- Punimi seminarik	90-100	9 (nëntë) (B)
	- Testi I	80-89	8 (tetë) (C)
	- Testi II	70-80	7 (shtatë) (D)
- Provimi përfundimtar	60-69	6 (gjashtë) (E)	
		50-59	5 (pesë) (F)
Politikat akademike dhe kodi i sjelljes:	Studentët duhet të jenë të rregullt në ligjërata dhe ushtrime dhe të jetë aktiv gjatë kursit mësimor. Nuk lejohet prishja e qetësisë dhe përdorimi i telefonit gjatë orëve të mësimit.		